

AKT THEMELIMI & STATUTI

I SHOQERISE “ ENDRYS Bond” shpk, TIRANE

Sot me date 26 Tetor 2022 (dymije e njezet e dy) u vendos krijimi i shoqerise ne prani te:
Z. Endris Behi , lindur me dt 24/12/1999 ne Shkoder , banues ne Tirane, me nr ID J91224038B ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise

Ortaku i vetem, themelues redakton aktin e themelimit dhe statutin nepermjet te cilit deklaroi se me vullnet te lire te plote e te sinqerte dhe me iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe kodit civil ne fuqi, ne baze te ligjit 9901, dt 14.04.2008 “per Tregetaret dhe shoqerite tregtare”, ligjit nr 9723 dt 03.05.2007 “ per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate doganor, fiskal e tatimor, krijon shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “ENDRYS Bond” shpk, Tirane.

Neni 1
Krijimi

Shoqeria “ENDRYS Bond” shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”)

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Shoqeria “ENDRYS Bond” shpk, Tirane eshte nje e tille, kapitali i se ciles ndahet ne kuota dhe qe themelohet nga ortakët qe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline ne: Fshati Mezes, Komuna Kashar prane godines se Hyundai ne autostraden Tirane-Durres, km 2 Tirane

Shoqeria mund ta ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filial, si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Import Eksport, Tregti me shumice dhe pakice makineri industriale, materiale ndertimi, punime fasadash, tregti profile alumini, perpunim materialesh, aksesori materialesh industrial, ndertimi, skeleri etj

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 6

Kapitali themelor

Kapitali themeltar I shoqërisë është 100,000 leke (njëqind mijë leke) i ndarë në një pjesë me vlerë nominale 100,000 leke. Kapitali I mesipër është nënshkruar dhe shlyer teresisht nga ortakut I vetëm i shoqërisë Z. Endris Behi, i cili zotëron 1 kuotë përkatesisht 100% të kapitalit themeltar me vlerë të përgjithshme të kapitalit 100,000 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme e as me kontribute në shërbime.

Ortakut përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tregëve deri në vlerën e kontributit të tij me kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zhvillimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakëve/ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabel të autorizuar, në rast se ka të tillë, të pakten 45 ditë para datës së mbledhjes së Ortakëve/ortakut të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë me të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të pakten deri në vlerë minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakëve/ortakut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirish të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme nëndërmjet bashkëshortëve, si dhe nëndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Neni 9

Organi vendimarrës

Ortakut i vetëm i shoqërisë është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Ortakut i vetëm i shoqërisë është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku i vetem i shoqerise brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilacin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratoret, Ato mund te perfaqesohen edhe nga nje person tjetër.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i Vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11

Administrimi

Administrator i shoqerise do jete Z. Endris Behi per nje afat 5 vjecar dhe ortak I vetem do jete Z. Endris Behi

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Neni 12

Kompetencat

Administratori dhe ortakut kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori dhe ortakut me te drejta te barabarta angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te tretteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethana te dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit dhe ortakut, te cilat rrjedhin nga ky nen duhet te respektohen nga te tretet.

Administratori ose ortakut qe nuk jane persona juridike nuk u lejohet te kontraktone ne çfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te tretteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori dhe ortakut jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te tretteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga ortakut qe i sjellin dem shoqerise, I ngarkohen administratorit qe ka bere marreveshjen, per ta perballuar ne menyre individuale pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakut ka te drejte te ngreje padi penale ndaj administratorit.

Ortakut ka te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Ortakut, qe nuk eshte administrator, ka te drejte ne çdo kohe te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar I Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e viti te meparshem financiar, siç edhe parashikohet ligji.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Ortaket, te cilet jo vetem qe dokumentojne miratimin e tyre por vendosin ne lidhje me dispoibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

Neni 18

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, I mbesin dhe I kalojne ne pronesi, ortakeve te shoqerise.

Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfare do shkakut, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar siç mund te jene:

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emrtesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqeria, me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.

Ortaku i vetem shoqerise, qe ben kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfitojne pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompensim me para, vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10 perqind te vleres nominale te pjeseve te kapitali themeltar te dhena.

Operacionet e lartpermendura mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise qe zhduket, dhe kalimin e plote te trashegimise se saj te shoqerite perfituese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerive qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati I emerimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne QKB.

Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit per QKB, Kodit Civil dhe çfaredolloj ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 24

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin me zbatimin apo interpretimin e ketij statute, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 25

Dispozita perfundimtare

Ky akt u redaktua ne gjuhen shqipe dhe u miratua nga Ortaket e shoqerise tregtare " ENDRYS Bond " shpk, Tirane.

Administratori:

Endris Behi

